



Prill, 2008

“Të festojmë së bashku 8 Prillin/

Ditën Ndërkombëtare të Rromëve.”

Dita Nderkombetare e romeve eshte nje nga festimet e pakta qe minoriteti rrom ne te gjithë boten gezon. Ne vitin 1990 ky u be nje eveniment nderkombetar. Megjithese rromet jetojne te shperndare ne shtete te ndryshme, ata perpiqen ta festojne te gjithë 8 Prillin, po aq sa perpiqen te gjejne edhe simbole te perbashketa. Disa here ky eveniment eshte festuar nepermjet mbjelljes se pemeve, disa here te tjera nepermjet dritave te qirinjve ose nepermjet hedhjes se luleve ne lumenj. Jane hedhur lule pergjate Nilit, Lumit Amazona, gjithashtu edhe pergjate lumit Czech Vltava. Megjithese jane bere shume perpjekje, paradoksalisht, ky eveniment nuk eshte shume i njohur nga mazhoranca, por nuk eshte shume i njohur edhe ne rradhet e romeve vet. Vetem njerzit qe punojne ne sektorin civil, te cilet perpiqen te organizojne festimet ne qytete te ndryshme dhe vende te ndryshme, kane informacion rreth ketij eventi.

Fillimi i viteve ‘70 solli aspiratat e para te emancipuesve nga niveli kombetar dhe nderkombetar i organizatave. Pikerisht ne 8 Prill 1971, eshte organizuar takimi i pare Nderkombetar Rrom ne Londer. Personalitete te rendesishme gjate ketij takimi kane qene Grattan Puxon dhe Donald Kenrick nga Anglia, Jarko Jovanoci nga Jugosllavia, Mat Maximoffem nga Franca, dhe shume te tjere. Ne Londer, delegatet e konferences se pare kontribuan zyrtarisht ne themelimin e organizates se pare nderkombetare rome, qe u quajt IRU (Unioni Nderkombetar Rrom). IRU u quajt UNIONI boteror i Rromeve qysh ne fillimet e tij. Nje tjetër output i kesaj konference , ka qene diferencimi i bere midis konceptit **Rrom** dhe **Egjiptian**. Gjate kesaj konference jane dhene edhe dy attribute shume sinjifikative te nje kombi; eshte vendosur Flamuri Rrom dhe eshte vendosur edhe rreth himnit rrom i cili do te ishte “Gelem-Gelem”.

Megjithese jane organizuar edhe dy kongrese te tjera nga Iru me vone, 8 Prilli eshte cilesuar dhe vazhdon te kujtohet si Dita Nderkombetare e Rromeve. Ne vitin 1990 ne Varshave eshte mbajtur konferenca e katert nderkombetare. Por data 8 Prill ishte data zyrtare e aprovimit te festes nderkombetare. Qysh nga ajo kohe, levizja rrome ka marre dimension nderkombetar dhe socio-politik. Gjate nje dite te tille, te gjithë pjesemarresit e festimeve kujtojne origjinen e tyre te perbashket, gjuhen, kulturen, unitetin dhe bashkepunimin dhe sidomos “romipen”, qe do te thote konservimin e identitetit.

Papa Jan Pavel II ka luajtur nje rol shume te rendesishem ne popullarizimin e dites Nderkombetare Rrome, sidomos ne vendet kristiane ne vitin 2000. Ai perdori audiencon

qe ishte prezente ne 8 Prill ne sheshin para Vatikanit “Peter Square” per t’i ftuar ata drejt me shume respekti kundrejt minoritetit rom.

Situata në Shqipëri: Unioni i Rromëve të Shqipërisë Amaro-Drom në bashkëpunim me partnerët e tij që vijnë më poshtë organizoi me sukses në datën 8 Prill 2008 aktivitetet e parashikuara ne te cilat morën pjesë përfaqësues të komuniteteve rrome nga e gjithë Shqipëria. Këto aktivitete u organizuan në përmbushje të qëllimit kryesor për të cilin u programua dhe projektua gjithë vargu i aktiviteteve të datës 8 Prill 2008; *Një ditë për festimin e kulturës rrome dhe rritje e ndërgjegjësimit për problemet me të cilat përballen komuniteti Rrom në Shqipëri.*

Pavarësisht se ka më tepër ndërveprim vitet e fundit mes rromëve dhe jo-rromëve dhe nivel më të ulët diskriminimi dhe paragjykimi kundrejt tyre, problemi është se maxhoranca, madje edhe shume prej rromëve në Shqipëri, ende nuk e dinë se me çfarë lidhet 8 Prilli.

Ky projekt kishte si qëllim kryesor rritjen e ndërgjegjësimit për sa i përket rëndësisë së Ditës Ndërkombëtare të Rromëve, përmes demonstrimit të aspekteve të ndryshme të kulturës së rromëve dhe të problemeve me të cilat përballen Rromët në Shqipëri.

UNIONI i Rromëve të Shqipërisë tashmë u bënë shumë vite që e ka kthyer në traditë festimin e Ditës Ndërkombëtare të Rromëve. Forma e organizimit të kësaj dite ka qenë nga viti në vit e ndryshme, por asnjë vit impakti dhe mesazhet që ka përcjellë kjo festë nuk kanë qenë të dimensioneve të këtij viti. Është bërë e mundur tërheqja e vëmendjes së gjithë mediave dhe gjithkush më datën 8 prill diskutoi rreth “Ditës Ndërkombëtare të Rromëve”.

Partnerë:

Partnerë në realizimin e aktivitetit “Të festojmë së bashku 8 Prillin/ Ditën Ndërkombëtare të rromëve”:

1. UNIONI i Rromëve të Shqipërisë Amaro-Drom,
2. Romani Baxt,
3. Rromët për Integrim,
4. Qendra për Vizion Bashkëkohor Rrom,
5. Drita e Gruas Rrome,
6. Disirturni Albania Korçë,
7. fëmijët, studentët, Forumi Rinor, Forumi i gruas, përfaqësues rrom nga të gjitha anët e Shqipërisë.
8. Shoqatat Lokale rrome,
9. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve,
10. Pushteti lokal,
11. Bashkia Tiranë,

12. Birra Tirana,
13. Bar/ Restorant “Mangalli”,
14. Teatri i Estradës Tiranë,
15. Terre des Hommes.

Përshkrim i aktiviteteve të zbatuara:

Aktiviteti nr. 1- Simpozium i organizuar në ambjentet e Muzeut Kombëtar.



Aktiviteti i parë i programuar për të festuar 8 Prillin ishte Simpoziumi. Simpoziumi u zhvillua pranë ambjenteve të Muzeut Kombëtar siç ishte planifikuar, duke filluar nga ora 10⁰⁰ deri në orën 12⁰⁰.

Për organizimin dhe planifikimin e simpoziumit u realizuan takime të vazhdueshme me përfaqësuesit e organizatave rrome, partnerë për zhvillimin e festimit të 8 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Romëve, ndër të cilët;

- Gjithë stafi i Amaro-Drom si menaxhuesi kryesor i aktiviteteve,
- Z. Pëllumb Furtuna si përfaqësues i organizatës Romani Baxt Albania,
- Znj. Suzana Rakipi, përfaqësuese e shoqatës Drita e gruas Rome Fushë-Krujë,
- Z. Arben Bastri dhe znj. Silvana Bastri si përfaqësues të Qendra për një Vizion Bashkëkohor Rrom,
- Z. Estref Pëllumbi si përfaqësues i Rromët për Integrim,
- Dhe përfaqësues të tjerë të komuniteteve rrome.

Gjatë takimit të parë së bashku gjithë liderat rrom diskutuan për të hartuar programin ditor për festimin e Festës Ndërkombëtare të Romëve.

Simpoziumi u hap me ekzekutimin e himnit rrom nga grupi i talentuar i të rinjve dhe profesionistëve rrom “Romano Dives”, pasuar nga tre pjesë të tjera muzike tradicionale rrome, të cilat e elekrizuan sallën. Himni i paraqitur në mënyrë solemne nga ky grup transmetoi emocione të jashtëzakonshme tek të gjithë të pranishmit. Ekzekutimi i himnit dhe pjesëve të tjera muzikore pasqyruan simbolikisht ato elemente aq të rëndësishëm të traditës dhe kulturës rrome, të cilat janë ruajtur dhe konservuar brez pas brezi, duke bërë që ky minoritet të ruaj deri në ditët e sotme identitetin e tij.

Pjesëmarrës gjatë simpoziumit kanë qenë 256 persona.

Znj. Silvana Bastri ishte moderatore e simpoziумit, ajo e ka lehtësuar jashtë mase gjatë gjithë kohës zhvillimin e aktivitetit; duke bërë të mundur dhe lejuar që gjithë drejtuesit e organizatave kryesore rrome të shprehnin idetë dhe urimet e tyre në lidhje me rastin e kësaj dite kaq të veçantë. Ndër tyre fjalën e hapjes e çeli z. Skënder Veliu, Drejtor Ekzekutiv i UNIONIT të Rromëve të Shqipërisë i cili uroi gjithë rromët kudo në botë me rastin e festës së tyre ndërkombëtare, ai gjithashtu uroi dhe përgëzoi gjithë njerzit pavarësisht nga përkatësia e tyre me rastin e kësaj feste, gjithë ata që respektojnë rromët në botë, gjithë ata që kanë dhënë kontributin e tyre sado pak për përmirësimin e kushteve të jetesës së këtij minoriteti dhe që kanë ndikuar në respektimin e të drejtave të tyre. Duke mos lenë pa përmendur këtu kontributin e madh të Terre Des Hommes, i cili ka mbështetur dhe vazhdon të mbështesë nisma dhe aktivitete në zhvillimin e Minoritetit Rrom në Shqipëri.

Z. Skënder Veliu përgëzoi gjithë partneerët që bënë të mundur realimin e vargut të aktiviteteve me rastin e 8 prillit, në veçanti organizatat rrome, të cilat për herë të parë bashkëpunuan në mënyrë kaq të frytshme së bashku, dhe nuk la pa përmendur teorinë “Rromët për Rromët”, mbi të cilën do të mbështetej pjesa më e madhe e aktiviteteve të ditës.

Z. Lefter Maliqi, Kryetar i Komunës Otllak, foli në emër të Pushteti Lokal në përgjithësi, duke shprehur gadishmërinë e tij për t’i ardhur në ndihmë komunitetit rrom. Ai përshëndeti gjithë pjesëmarrësit dhe uroi mbarë shqiptarët në lidhje me festën.

Në rradhën e të ftuarve “specialë” në nderim të evenimentit u ftua të fliste edhe z. Refik Tare, si përfaqësues rrom në Komitetin Shtetëror të Minoriteteve. Në emër të Komitetit z. Tare shprehu kënaqësinë e tij për pjesëmarrjen në një eveniment kaq të rëndësishëm për minoritetin rrom jo vetëm në Shqipëri por, për të gjithë rromët e botës. Ai përfitoi nga rasti të shprehte disa nga rezultatet e punës kërkimore të Komitetit Shtetëror të Minoriteteve në bashkëpunim me organizatat rrome, ndër të cilat me një rëndësi të veçantë Amaro-Drom, duke dhënë një panoramë të përgjithshme të situatës së Minoritetit Rrom në Shqipëri, problematikave të tyre.

U përshëndetën edhe misionerët rrom për të cilët ishte rezervuar të shprehnin urimin e tyre gjatë simpoziумit, znj. Suzana Rakipi dhe Z. Pëllumb Furtuna, por që për shkak të impenjimeve të tjera po aq të rëndësishme në lidhje me festimin e 8 prillit, nuk ishin të pranishëm gjatë simpoziумit. Znj. Suzana Rakipi (Drita e Gruas Rrome) ishte e ftuar bashkë me z. Ferit Milanj (Amaro-Drom) pranë televizionit Vizion +, në një transmetim të drejtëpërdrejtë për të folur në lidhje me ditën më të rëndësishme të rromëve në mbarë botën. Ndërkohë që z. Pëllumb Furtuna (Romani Baxt Albania) ishte i angazhuar së bashku me znj. Marsela Avxhiu (Amaro-Drom) në shoqërimin e delegacioneve me fëmijë pranë instancave shtetërore; Presidencë, Kryeministri dhe Parlament. Edhe z. Estref Pëllumbi (Rromët për Integrim) dhe znj. Silvana bastri (Qendra për një Vizion bashkëkohor Rrom) përshëndetën gjithë pjesëmarrësit e aktivitetit dhe gjithë rromët me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Rromëve.

Duke shfrytëzuar rastin z. Pandeli Theodhori, përfaqësues nga shoqëria civile shqiptare, dhe më specifikisht drejtor i “Fondacioni Shqiptar i Shoqërisë Civile”, përshëndeti gjithë të pranishmit me rastin e festës dhe bëri një rezumë të punës së bërë prej fondacionit të tij në komunitetin rrom të Kucoës.

Një mësues nga komuniteti Stan/ Moravë, z. Veli Gishti foli para të gjithëve dhe theksoi de duhet t’i jepet rëndësi e veçantë problemit të arsimimit të rromëve në Shqipëri, sepse

niveli arsimor i romëve është shumë i ulët dhe është baza e gjithë problemeve të tjera që vijnë më pas, si papunësia, strehimi, trafikimi, shëndetësia etj.

Ashtu siç u nis simpoziumi u mbyll nën ritmin e bukur të grupit të instrumentistëve, duke shpalosur edhe njëherë copëza të traditës etno-culturore të romëve trashëguar brez pas brezi.

Aktiviteti nr. 2- Manifestim në “Sheshin Skënderbej”.



Aktiviteteteve iu erdhi momenti që të thyenin cdo kufizim metode dhe hapësire, për të shprehur si asnjëherë më parë në të vërtetë ashtu sic duhet në një ditë ndërkombëtare problemet dhe nevojat e këtij komuniteti drejt një ndërgjegjësimi më të gjerë të të gjithë shqiptarëve për respektimin e të drejtave të Minoritetit Rom. Të gjithë pjesëmarrësit, ashtu siç ishin së bashku, duke mbajtur nga një lule në dorë dhe disa prej tyre pankarta me sloganet që bënin thirrje, morën pjesë në një manifestim paqësor duke shkuar në këmbë të heshtur nga ambjentet e Muzeut Kombëtar, drejt Sheshit Skënderbej. Aty u qëndrua për rreth gjysmë ore duke u bërë thirrje gjithë shqiptarëve dhe gjithë botes, dhe për ironi të pozicionimit të tyre dhe gjithë godinave kryesore të Pushtetit Qendror dhe atij Lokal që shtrihen përreth Sheshit Skënderbej. Ndër sloganet kryesore të përdorura ishin si më poshtë:

- 1) **O RROMA ISI EVROPA ! RROMET JANE EVROPE !**
- 2) **JO - PARAGJYKIMEVE , PO - INTEGRIMIT**
- 3) **TE NGREJME NIVELIN ARSIMOR, SOCIAL-EKONOMIK, TE RROMEVE**
- 4) **FEMJET RROM – JO VIKTIMA TE TRAFIKIMIT , POR – FIDANE TE INTEGRIMIT**
- 5) **INTEGRIMI I RROMEVE – KERKES E BASHKIMIT EUROPIAN**
- 6) **RROMET – QYTETARE TE SHOQERISE DEMOKRATIKE**
- 7) **SË BASHKU PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM**
- 8) **NE I DETYROHEMI FËMIJËVE TANË “NJË JETË PA DHUNË DHE FRIKË”**
- 9) **QEVERIA TË ZBATOJË STRATEGJINË**
- 10) **TOLERANCË DHE MIRËKUPTIM**
- 11) **E DREJTË UNIVERSALE; QYTETARË TË BARABARTË**
- 12) **NJË BOTË PAQEJE; PA RACIZËM DHE DISKRIMINIM**

Aktiviteti nr. 3- Delegacion fëmijësh të cilët vizitojnë Presidencën, Kryeministrinë, Parlamentin dhe Bashkinë e Tiranës.

Takim miqësor i fëmijëve të Minoritetit Rrom me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, z. Bamir Topi.



Me rastin e 8 Prillit, Ditës Botërore të Rromëve, Presidenti i Republikës së Shqipërisë Bamir Topi, priti në presidencë një përfaqësi të përbërë nga 20 fëmijë të shoqëruar nga përfaqësues të UNIONIT të Rromëve të Shqipërisë “Amaro-Drom”.

z. Topi u përshëndet nga afër me të ftuarit duke u shprehur i kënaqur për këtë takim miqësor dhe për mundësinë e bashkëbisedimit të hapur e të përzemërt me këta fëmijë. Presidenti Topi u interesua për

mbarëvajtjen e fëmijëve në shkollë duke i pyetur fëmijët me rradhë se në çfarë shkolle dhe klase ishin, kush ishte lënda e tyre e preferuar, kishin vështirësi në ndonjë lëndë në shkollë etj. Më pas Presidenti Topi vuri në dukje rëndësinë e punës me përkushtim për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për fëmijët, për të mundësuar për ta kushte dhe standarte të larta të edukimit dhe arsimimit. Z. Topi i kushtoi rëndësi në fjalimin e tij edhe çështjes së vaksinimit të fëmijëve të këtij komuniteti në mënyrë që të gjithë fëmijët të ndihen plotësisht të integruar në shoqëri, si qytetarë të barabartë me të drejta të plota.

Presidenti i Republikës i uroi pjesëmarrësit në këtë takim me rastin e Ditës Botërore të Rromëve duke i uruar që të zbavitëshin sa më shumë pasi ai ishte i informuar se gjatë kësaj dite ishin programuar për t’u organizuar aktivitete të ndryshme. Z. Topi vlerësoi bashkëjetesën dhe harmoninë shoqërore mes të gjithë komuniteteve në vend. Kryetari i Shtetit theksoi faktin se komuniteti rrom në një vënd pa diskriminim si Shqipëria, ndihet i mbështetur dhe duhet përfaqësuar në të gjitha nivelet e pushtetit vendor madje të ketë edhe përfaqësuesin e vet në parlament. z. Topi theksoi gjithashtu se arritjet pozitive të Shqipërisë drejt antarësimit në NATO dhe integritimit drejt Bashkimit Europian janë edhe një nxitje më shumë për të pasur njerëz të denjë dhe profesionistë dhe kjo mund të arrihet në sajë të edukimit dhe arsimimit të brezit të ri. Përfaqësuesja e UNIONIT të Rromëve të Shqipërisë “Amaro-Drom” shprehu mirënjohjen e thellë për pritjen që iu rezervua këtyre fëmijëve nga ana e Presidentit Topi. Fëmijët i dhuruan në shënjë respekti dhe dashamirësie një shportë me lule pjesë kjo e traditës së Minoritetit Rrom dhe bashkangjitur me këtë shportë me lule një kartolinë e cila përmbante mesazhin që vjen nga Minoriteti Rrom në Shqipëri. Në të njëjtën kohë ata i drejtuan urimet më të mira për ftesën e anëtarësimit të vendit në NATO, duke vlerësuar reformat e ndërmarra, që sipas tyre janë edhe në kontribut të mirëqënies së komunitetit rrom në Shqipëri. Në fund të takimit, të ftuarit bënë një fotografi me Presidentin e vendit të tyre në mënyrë që të kujtojnë gjithmonë këtë takim shumë të rëndësishëm. Fëmijët u përshëndetën me z. Topi i cili i këshilloi që të mësojnë në shkollë dhe u premtoi se do të punojë më shumë për ta.

Takim miqësor i fëmijëve më Kryetaren e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, znj. Jozefina Topalli.



Delegacioni i fëmijëve vazhdoi vizitën në ambjentet e Kuvendit Popullor. Fëmijët u pritën shumë përzemërsisht nga stafi i Znj. Topalli të cilët u kujdesën për t'u treguar të ftuarve ambjentet e Kuvendit Popullor të Shqipërisë. Fëmijët vizituan nga afër sallat në të cilat mbledhen komisionet e deputeteve që diskutojnë ligjet e vendit. Ata u ulën në karriket ku ulen deputetet duke e menduar veten deputetë të ardhshëm të vëndit. Njëri prej fëmijëve provoi të fliste nga foltoria ku znj. Jozefina Topalli

jep konferencat për shtyp. Më pas fëmijët u akomoduan në një sallë ku dë të prisnin të takonin kryetaren e Kuvendit. Znj. Topalli i takoi të gjithë fëmijët me rradhë dhe i pyeti si quheshin, sa vjeç ishin, në cilën shkollë shkonin, kush ishte lënda e preferuar etj. Duke parë se pjesa me e madhe e fëmijëve ishin nga shkolla “Bajram Curri”, Znj. Topalli i ftoi fëmijët që bashkë me të gjithë nxënësit e tjerë të shkollës të bënin një vizitë në sallën e parlamentit.

Njëri prej fëmijëve i dhuroi gjithashtu edhe znj. Topalli shportën me lule të shoqëruar me kartolinën që ishte përgatitur për të, e cila përmbante mesazhin e minoritetit rom dhe urimet më të përzemërta për të.

Znj. Topalli i uroi fëmijët për festën e tyre dhe theksoi se të gjithë duhet të punojnë më shumë në mënyrë që fëmijët të kenë kushte dhe një të ardhme më të mirë, por edhe fëmijët duhet të mësojnë sa më shumë në shkollë. Znj. Topalli tha se komuniteti rom është një komunitet i cili ka një traditë shumë të pasur dhe gjithashtu vlerësoi bashkëjetesën e këtij minoriteti me pjesën tjetër të popullsisë. Në përfundim të bisedës, znj. Topalli u përshëndet me të ftuarit dhe i uroi edhe një herë për festën e 8 Prillit.

Takim i fëmijëve me Kryeministrin e Shqipërisë, z. Sali Berisha.

Delegacioni i fëmijëve të shoqëruar nga një përfaqësuese e shoqatës “Drita e Gruas Rrome” dhe UNIONI “Amaro-Drom”, sipas axhendës, vazhdoi vizitën në ambjentet e kryeministrisë për të takuar nga afër Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë.

Z. Berisha i puthi me rradhë të gjithë fëmijët dhe u shpreh se ndihej shumë i kënaqur që kishte të ftuar fëmijë simpatikë dhe të edukuar një një ditë shumë të rëndësishme për Minoritetin Rom, siç është 8 Prilli.



Edhe z. Berisha u ndje shumë i kënaqur për dhuratën që fëmijët i bënë, vizita e tyre në kryeministri dhe shporta me lule pjesë kjo e traditës rrome. Z. Kryeministër pranoi se duhet bërë më shumë për këtë komunitet dhe ka premtuar politika dhe strategji të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e jetesës së këtyre banorëve. Në fjalën e tij, z. Berisha i kushtoi rëndësi arsimimit të fëmijëve, domosdoshmëri kjo për të patur

një të ardhme më të mirë, mundësi më të mira punësimi etj. Në përfundim të takimit z. Berisha ndau dhurata për të gjithë fëmijët dhe i uroi të marrin nota sa më të mira në mësim.

Shënim- Takimi në Bashkinë Tiranë nuk u realizua si rezultat i mos marrjes së një konfirmimi nga ana e këtij institucioni për pritjen e delegacionit.

Aktiviteti nr. 4- Dreke “Festojmë të gjithë së bashku”.

Dreka festive me rastin e 8 prillit, Ditës Ndërkombëtare të Rromëve, u zhvillua në ambientet e Bar Restorant “Mangall-it” ne Tiranë.



Veçantia e kësaj dreke ishte pjesëmarrja e gjerë e rromëve të ardhur nga gjithë Shqipëria: Tirana, Korca, Fushë-Kruja, Berati, Lushnja, Vlora, Fieri, siguruar kjo nën mbështetjen e Terre des Hommes me mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të tyre. Ishin 100 të ftuar specialë nga rrethet që me entuziazmin dhe energjinë e tyre e cila buron qysh nga genet e trashëguara rrome; bën që dreka të ishte për të gjithë pjesëmarrësit një eveniment i veçantë për të festuar; dhe për ata të ftuar jo-rom nga shoqëria civile atmosfera e krijuar i bëri ta kishin zili për disa çaste të qenit rrom. Lëvizjet e mrekullueshme të trupit nga vajzat dhe gratë rrome, muzika e zgjedhur me shije nga lokali dhe herë herë e luajtur edhe nga të rinj rrom të cilët guxonin të këndonin për të pranishmit, bënë që kjo drekë të mbetej e paharrueshme për gjithë të pranishmit. Ne kete feste te madhe nuk mungoi as kontributi i grupit te muzikanteve ne lokal me mjeshterin e madh te muzikes z.Fatmir Lela.

Nderuan me praninë e tyre përfaqësues nga shoqëria civile shqiptare; si z.Pandi Theodhori nga Fondacioni Shqiptar i Shoqërisë Civile, përfaqësuesit e Komitetit Shtetëror për Minoritetet në Shqipëri. z.Refik Tare dhe z.Foto Nikolla, liderat rrom etj.

Metodologjia e përdorur për mbulimin e shpenzimeve të drekës ishte “Rromët për Rromët”, shumë prej tyre duke qenë se janë në kushte shumë të vështira ekonomike, Amaro-drom bëri një mbulim të pjesshëm të shpenzimeve të tyre. Nuk duhet të lemë pa përmendur edhe mbështetjen në dhënien e një oferte shumë të mirë nga ana e Restorantit, dhe Birra Tirana duke u bërë edhe këta pjesë e sponsorve të këtij aktiviteti.

Ushqimi dhe ambjentet e lokalit ishin të një niveli shumë të mirë dhe të përshtatshme për një eveniment të tillë.

Të gjithë pjesëmarrësit mbetën shumë të kënaqur.

Aktiviteti nr. 5- Koncert festiv me muzike rome, ambjentet e Estradës së Tiranës.



Pjesë e kalendarit të aktiviteteve të organizuara me rastin e 8 Prillit ishte edhe një koncert festiv i cili u shfaq në ambjentet Teatrit të Estradës së Tiranës. Ky koncert u mundësua falë angazhimit të Qendrës për një Vizion Bashkëkohor Rrom, e cila kishte marrë përsipër përgjegjësinë e organizimit të këtij koncerti. Kontribut shumë të çmuar dha Bashkia e Tiranës e cila bëri të mundur që ky koncert të organizohej në ambjentet e Teatrit të Estradës së Tiranës falas, gjithashtu edhe muzikantët dhe

instrumentistët të cilët performuan për të pranishmit për gati 2 orë. Ky koncert ishte kurorëzimi i të gjitha aktiviteteve të ditës festive, ku u vu re një pjesëmarrje masive nga komuniteti rrom por jo vetëm, gati rreth 500 pjesëmarrës.

Realizimi i këtij koncerti kishte si qëllim shpalosjen e traditës dhe kulturës të bukur rome, ku një pjesë të konsiderueshme e zë muzika dhe nëpërmjet saj trasmetimi i mesazheve sensibilizuese për të pranishmit.



Koncerti filloi me ekzekutimin e himnit rrom nga muzikantët e talentuar dhe më pas vazhdoi me ekzekutimin e këngëve të ndryshme nga repertori i pasur i traditës së Minoritetit rrom. Në sallë u krijua një atmosferë shumë festive, pjesëmarrësit këndonin dhe kërcenin bashkë me këngëtarët. Disa vajza të vogla, të veshura me kostume tradicionale të kulturës rome,

shoqëruan disa prej këngëve ritmike të performuara gjatë koncertit.

Në përfundim koncerti u mbyll me performimin e Himnit Europjan nga Znj. Silvana Bastri dhe një tjetër këngëtar i famshëm rrom.

Rezultatet e arritura:

1. Ndergjegjesim me i madh i shoqerise rreth evenimentit te Dites Nderkombetare te Rromeve;
2. Respekt, mbrojtje dhe promovim i kultures rome si nje pjese integrale e pasurise kulturore shqiptare.
3. Ky aktivitet do te jape impulse ne inicimin e zhvillimit te marredhenieve tolerante dhe demokratike ne Shqiperi; Kapercimin e stereotipeve prezente dhe paragjykimeve kunder romeve; Zhvillimin e Interdialogut ndermjet romeve dhe jo-romeve ne Shqiperi;
4. Ekspozim i aspekteve pozitive dhe nje perfaqesim i balancuar i kultures rome ne media gjate evenimentit.
5. Numer me i madh i njerzve qe kane informacion rreth kuptimit te dates 8 Prill.

Vlerësimi:

Një instrument kryesor për të vlerësuar impaktin që la ky festim e tregon numri i madh i mediave që kanë paraqitur drejtëpërsëdrejti evenimentet e zhvilluara, dhe lajmet e të gjitha stacioneve më të njohura publike shqiptare. Shikueshmëria në media ka qenë e një niveli të lartë. Gjithashtu edhe shtypi i shkruar i ka kushtuar një vend shumë të rëndësishëm ditën e nesërme aktiviteteve të 8 Prillit.

Menjëherë të nesërmën impakti i madh u ndje edhe ne si organizatorë të aktivitetit, të gjithë njerzit na përshëndesnin në rrugë dhe na uronin në lidhje me festën.

Delegacionet e fëmijëve gjithashtu luajtën një rol shumë të rëndësishëm për nga impakti i tyre në nivele të Institucioneve shtetërore në të cilat shkuan.

Qoftë Kryeministri, Presidenti dhe Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, na premtuan se do të bënin të pamundurën në vazhdim për të siguruar implementimin e gjithë iniciativave qeveritare si implementimi i startegjisë etj. Ata na premtuan se do të punohet për iniciuar edhe nisma të reja për të përmirësuar kushtet e jetesës së Minoritetit Rrom në Shqipëri.

Në datën 16 Prill pranë zyrave të Amaro-Drom erdhi një grup pune nga Drejtoria e Organizatave Ndërkombëtare/ Zyra e Minoriteteve, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, i cili kërkoi nga ne të merrte më shumë informacion rreth problematikave me të cilat përballet minoriteti rrom sot, dhe më specifikisht për të deleguar zërin tonë në Pushtetin Qendror rreth atyre problemeve të evidentuara prej nesh si më imediate, që kërkojnë ndërhyrjen e menjëhershme nga Shteti Shqiptar.

Festimit i 8 Prillit ka dhënë rezultate të qëndrueshme, duke motivuar vet përfaqësuesit e organizatave rrom, shoqëri civile dhe institucionet qeveritare shqiptare për të bërë më shumë në të ardhmen për komunitetin rrom në Shqipëri drejt një integrimi në një shoqëri më demokratike evropiane.

MEDIA dhe 8 Prilli, Dita ndërkombëtare e rromëve.

Me rastin e festës së 8 Prillit, televizione të ndryshme transmetuan kronika dhe informacion me rastin e këtij eventi. Ishin të pranishme disa televizione si: Televizioni Publik Shqiptar, Tv A1, Vizion Plus, Mediasat, Top neës, Tv Adriatik, Neës 24 etj.

Krahas medias së shkruar edhe media vizive i bëri jehonë këtij aktiviteti.

Gazeta “Ndryshe” në faqen e dytë të saj botoi artikullin “ Fëmijët e bashkësisë rrome të ndihen dhe të jetojnë plotësisht të integruar në shoqëri si qytetarë të barabartë me të drejta të plota” dhe nëntitullin “Presidenti Topi, takim miqësor me fëmijët e bashkësisë rrome”. Edhe gazeta “Koha Jonë” në rubrikën e saj sociale i bëri jehonë aktivitetit të 8 prillit. Në faqet e kësaj gazete botohet fotografia e fëmijëve rromë së bashku me Presidentin e Republikës z. Bamir Topi. Kjo foto shoqërohet me mesazhin e Presidentit drejtuar të gjithë fëmijëve rromë për një të ardhme më të mirë dhe një shkollim si të gjithë fëmijët e tjerë të maxhorancës, me të drejta të barabarta.

Televizioni Publik Shqiptar, në emisionin e orës 9⁰⁰ “Ftesë për kafe”, ftoi z. Skënder Veliu, Drejtor i qendrës “Amaro-Drom” për të folur për rëndësinë e festës së 8 Prillit, për probleme të ndryshme me të cilat përballet Minoriteti rrom në Shqipëri dhe për perspektivën që ka ky Minoritet për të ardhmen.

Z. Veliu ka qënë i ftuar edhe në televizionin Vizion plus po për të njëjtën arsye. Po në të njëjtin televizion znj. Suzana Rakipi dhe z. Ferit Milanj kanë qënë të ftuar në emisionin “kontakt” ku iu përgjigjën pyetjeve të drejtuara nga gazetarja e emisionit për probleme të ndryshme që ka Minoriteti Rrom, sidomos gruaja rrome, roli i saj në shoqëri, respektimi në familje etj. Përgjigjet e të dy të ftuarve ishin profesionale. Media vizive dhe ajo e shkruar e përcollën aktivitetin e 8 prillit me dashamirësi dhe profesionalizëm duke shmangur gjuhën e urejtjes dhe stereotipet e padëshiruara.

UNIONI i Rromëve të Shqipërisë/ Amaro-Drom